

VENDIM
Nr.358, datë 4.5.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I OBJEKTEVE
“RIKOSTRUKSIONI I SHKOLLËS “THANAS BOZO”, NDËRTIMI I PALESTRËS
DHE TERRENET SPORTIVE KOLONJË”, BASHKIA LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i objektit “Rikostruksioni i shkollës “Thanas Bozo”, ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë”, Bashkia Lushnjë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 1 930 435 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 930 435 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë, për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Lushnjë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, në favor të Bashkisë Lushnjë, për pasuritë e shpronësuar.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i objektit :
“Rikonstruksioni i shkollës ‘Thanas Bozo’, ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë”**

Nr	ZK	Nr. i Pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqja truallit (m ²)	Cmimi i truallit (lekë/m ²)	Vlera truallit (lekë)	Sip. Ndërtesës (m ²)	Cmimi i ndërtesës (lekë/m ²)	Vlera ndërtese (lekë)	Vlera totale truall dhe ndërtesë (lekë)	Shënime
1	2207	3//36	Kolonjë Lushnje	Asqeri Çela	100	451	45,100	74	Me situacion	1,885,335.0	1,930,435.0	Shkresa nr. 7272/1 prot. dt. 11/09/2019; Vërtetim Hipotekor dt. 07/08/2019
Total											1,930,435	

Shënime:

1.Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt.03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2.Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138 dt. 23.03.2000 “Për Kriteret Teknike të Vlerësimit dhe të Përlllogaritjes së Masës së Shpërblimit të Pasurive Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik”, i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.